



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2022:149096

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519592

**PPP.nr.171/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbareme të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, rr “Bulevardi Bill Clinton”, nr.5, kundër debitorit V.G. nga Ferizaj, rr “...”, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit V.G., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.376/22, të datës 21.06.2022, i lëshuar nga përmbareusi privat B.T. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.4376/22, i datës 21.06.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.376/22, të datës 21.06.2022, përmbareusi privat B.T., e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), kundër debitorit V.G., për pagesën e shumës së borxhit prej 1,136.45 euro, në bazë të ekstraktit të librave afariste me numër DFE ..., të datës 21.06.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbareme, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbareusit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaremit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbareim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbareim P.nr.376/22, i datës 21.06.2022.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbuarim të kundërshtuar me prapësim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së dhe gjeti se :

### **Prapësimi i debitorit është i pabazuar**

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbuarim i lëshuar nga Përmbuaruesi privat Besnik Aliu nga Ferizaj, me numër P.nr.376/22, i datës 21.06.2022, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbuarimore ngase përmbuaruesi privat e ka lejuar përmbuarimin në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.3 dhe 1.4, të Ligjit për Procedurën Përmbuarimore.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se përmbuaruesi privat gjatë marrjes së urdhrin i cili atakohet ka bërë shkelje të dispozitave materialo juridike të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, për shkak se debitori e ka përmbushur tërë obligimin ndaj kreditorit për vitet deri me 2020 tërësisht, Gjykata këtë pretendim të debitorit e konsideron të pabazuar dhe të paqëndrueshëm sepse nga propozimi për përmbuarim i kreditorit, vërtetohet se kreditori borxhin e cekur në propozimin për përmbuarim në shumë prej 1,136.45 euro, e ka kërkuar për periudhën kohore prej 06.05.2020 e deri më 22.05.2020, e jo para vitit 2020 siç pretendon debitori se e ka përmbushur detyrimin para vitit 2020.

Gjithashtu, pretendimi i debitorit se me urdhrin përmbuarimor është shkelur dispozita ligjore e nenit 360, të LMD-së dhe atë neni 360, pika 1.1. Andaj, faturat për të cilat pretendon kreditori janë fatura të parashkruara meqë kreditori propozimin për përmbuarim e ka ushtruar me datën 21.06.2022 dhe urdhri për lejimin e përmbuarimit është i paligjshëm sa i përket shumës së borxhit 1,136.45 euro, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit, Gjykata konsideron se edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit dhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 360, par 1, i LMD-së, për arsye se në këtë rast është shkaktuar ndërprerja e afatit të parashkrimit nga neni 368, par 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është paraparë shprehimisht se : *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”* dhe me shikimin e shkresave të lëndës, gjegjësisht ekstraktit nga librat afariste të kreditorit, të datës DFE ..., të datës 21.06.2022, pagesën e bërë nga debitori me datën 15.03.2021, për faturën ..., për shumën e borxhit prej 8 euro, si dhe pagesën e bërë po ashtu nga debitori me datën 11.10.2021, të faturës ....., për shumën e borxhit prej 40.00 euro, ka konstatuar se debitori e ka pranuar borxhin që e ka ndaj kreditorit dhe si rezultat i këtij fakti nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit nga neni 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së.

Për më tepër në nenin 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, është paraparë shprehimisht se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe duke

e krahasuar datën e fundit të pagesës së shumës së borxhit prej 40.00 euro, e bërë më datë 11.10.2021 dhe datës kur kreditori e ka dorëzuar tek përbaruesi privat propozimin për përbarim, siç është data 21.06.2022, nënkupton se kreditori e ka dorëzuar propozimin për përbarim brenda periudhës prej një viti, respektivisht nuk ka kaluar afati prej 1 viti i kërkuar në nenin 360, par 1, të LMD-së dhe si rrjedhojë kërkesa e kreditorit nuk është parashkuar (vjetërsuar).

Përveç tjerash, Gjykata, bazuar në propozimin për përbarim të kreditorit, periudhës kohore prej 06.05.2020 deri më datën 22.05.2022, për të cilën kreditori ka kërkuar shumën e borxhit prej 1,136.45 euro, llogaritjes së faturave për këtë periudhë kohore në bazë të ekstraktit të librave afariste, ka ardhur në përfundimin se shuma e borxhit prej 1,136.45 euro, e kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim, përputhet në tërësi me periudhën kohore të cekur më lart.

Gjithashtu, gjykata konstatoj se propozimi për përbarim i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përbarim i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përbarim, dokumentin e besueshëm, siç është ekstrakti i verifikuar nga librat afariste në origjinal, kërkesin e përbarimit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjykata konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri për përbarim P.nr.376/22, i datës 21.06.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.171/22, më datë 28.03.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.